



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. ____ prot.

Data ____/11/2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34926000-4 Pajisje per kontrolle ne parkime

VLERA E FONDIT LIMIT:

1. . Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:

18 248 795.80 (tetembdhjete milion e dyqind e dyzet e tete mijë e shtateqind e nentedhjetë e pese presje ttetedhjete) leke pa Tvsh, ose 185 832.951 (njëqind e tetedhjete e pese mije e teteqind e tridhjete e dy presje nanteqind e pesedhjete e nje) euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për vitin 2024, për sipas Vendimit nr. Date te Keshillit Bashkiak .

Bazuar në *Nenin 42, pika 1 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”*. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Nëse objekti do ndahej në lote, studim projektimi do të bëhej pothuajse i pamundur për shkak se është i njëjti aks, për më tepër në Termat e Referencës është i gjithë përshkrimi. Gjithashtu, ndarja në lote e objektit do të komplikonte afatin e dorëzimit të projektit dhe do sillte vonesa për fillimin e zbatimit të punimeve ndërtimore.

Commented [D1]:

Commented [WU2R1]:

Commented [WU3R1]:

Commented [WU4R1]:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Në zbatim të pikës 2 të nenit 56 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të nenit 24 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor do të publikojë Njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në **Gazetën Europiane**.

Në zbatim të pikës 2 neni 12 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, Autoriteti kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë (Data , ora)

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, neni 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenit 43, pika 2, germa “a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Nga AK është përcaktuar “jo me e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet” me argumentimin për të pasur me shumë konkurrence dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim”. Kjo e mbështetur dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenit 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, *ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe te suksesshëm të kesaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se **40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar sipas përcaktimit në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Licenca profesionale e operatorëve ekonomikë e lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të projektimit sipas kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Kat 2. PROJEKTUES ARKITEKT

- 2. b. 2 Qendra Tregtare; Objekte social – kulturore; objekte kulti; objekte arsimore..
- 2.d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Kat 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- 3.a. Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- 3.c-1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike –
- 3.d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike

Kat 4. PROJEKTUES INSTALATOR

- 4.a. Projektim të instalimeve hidro-termosanitare
- 4. b. Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- 4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 4.f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit
- 4.g. Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.
- 4.h - Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.)
- 4.i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.
- 4.j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial.

Kat 5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- 5.b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkim

Kat 6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

- 6.a- Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Kat 8. PROJEKTUES GJEODET

8.a- Rivelime inxhinierike.

8.b- Rilevime inxhinierike kadastrale

Kat 9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

9.a Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate

d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Kat 10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

10.e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

Kat. 11. PROJEKTUES TE SINJALIZIMIT RRUGOR

11.a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

11.d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Kat 12 . STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore

c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Shënim: Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh VKM-në Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit kompetent në Republikën e Shqipërisë, konform VKM-së Nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë

23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr.759, datë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me detyrat dhe objektivat e përshkruara te Termat e Referencës në lidhje me objektin që do të projektohet si me poshte:

Kat 2. PROJEKTUES ARKITEKT

2. b. 2 Qendra Tregtare; Ogjekte social – kulturore; objekte kulti; objekte arsimore..

Argumentimi: Bazuar ne Termat e references Objekti ka karakter multifunksional ku perfshihen muze, auditor, ekspozita dhe ambiente per kurse formimi dhe gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

2.d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Argumentimi: Sipas termave te references Pjese e projektit jane dhe rivitalizimi I hapesires se gjelberuar si dhe veranda e gjelberuar gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

Kat 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

3.a. Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references objekti do te jete zones multifunksionale mbi parkimin nentokesor dhe si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

3.c-1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike –

Argumentimi: Parkimi nentokesor (2 kate nen toke) do te jete me strukture b/a dhe paraqet nivel te larte veshtiresie duke qene se sheshi i ndertimit ndodhet ne qender te qytetit dhe ka objekte te tjera ne afersi gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

3.d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike

Argumentimi: Parkimi nentokesor (2 kate nen toke) do te jete me strukture b/a dhe paraqet nivel te larte veshtiresie duke qene se sheshi i ndertimit ndodhet ne qender te qytetit dhe ka objekte te



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

tjera ne afersi gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

Kat 4. PROJEKTUES INSTALATOR

4.a. Projektim të instalimeve hidro-termosanitare

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, godina parashikohet per funksionin qe do te kryejne te kene sisteme te plot ate instalimeve hidro sanitare (tualete, furnizim me uje etj) si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

4. b. Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, godina do te propozohet te kene panvaresi te sistemeve elektrike ndermjet prodhimit te saj nga impiante te prodhimit te energjise termike.

4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, godina, per funksionin qe do te kryeje te kene sisteme te plot ate instalimeve elektrike, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

4.f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, godina parashikohet te jete e pajisur me sisteme kundra zjarrit dhe sidomos ne situatat emergjente per shuarjen e zjarreve, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

4.g. Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, godinat multifunksionale kane domosdoshmeri sistemet e monitorimit dhe automatizimit dhe integritit te sistemeve, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

4.h - Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.)

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, objekti propozohet te kete ashensore si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

4.i.- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

porteve aeroporteve etj.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, parashikohet realizimi i shesheve dhe ambienteve te pushimit te cilat do te kene ndricim, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

4.j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, godina do te jete e pajisur me te gjithë sistemet teknike te nevojshme per funksionet qe do te realizoje perfshire, sistemet e internetit, kamerat e sigurise, sistemet e alarmit per dedektimin e zjarrit etj, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

Kat 5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

5.b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkim

Argumentimi :Bazuar ne termat e references, per realizimin e objektit te parashikuar, parashikohet realizimi i kolektoreve te shkarkimit, furnizimi me uje, etj , KUZ te cilat do te lidhen me rrjetin ekzistues te qytetit si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

Kat 6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

6.a- Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Argumentimi: Projekti duhet te parashikojë aksesin e objektit me infrastrukturen vendore ekzistuese.

Kat 8. PROJEKTUES GJEODET

8.a- Rivelime inxhinierike.

Argumentimi:Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e rivevimeve te gjendjes ekzistuese te godines e, shesheve si dhe rruget e aksesit te ketij sheshi ndertimi etj per kete arsye duhet te ndertohet poligoni perkates i cili do te shfrytezohet edhe gjate fazes se zbatimit si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

8.b- Rivevime inxhinierike kadastrale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e rlevimeve kadastral te godines, shesheve si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

Kat 9. STUDIM GJEOLOGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

9.a Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate

9.d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, perpara fillimit te projektit duhet te realizohet studimi gjeologjik i sheshit te ndertimit per te patur ne dispozicion nje pasqyre te qarte te kushteve gjoemorfologjike te sheshit gjate projektimit te objektit.

Kat 10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGISJË

10.e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references objekti qe parashikohet te realizohet do te furnizohet me energji elektrike , i cili do te sigurohet nga realizimi i kabinave elektrike me linja te tensionit te ulet dhe te mesem per furnizim, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

Kat. 11. PROJEKTUES TE SINJALIZIMIT RRUGOR

11.a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references meqenese si pjese e projektit parashikohet realizimi i, parkimit dhe eshte e nevojshme parashikimi i realizimit te sinjalistikes jo ndricuese, tabela dhe vijezim horizontal si pjese integrale e projekteve te infrastruktures rrugore e jo vetem si dhe te rrugeve te aksesit ne objektin e ri, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

11.d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, parashikohet qe te behet parkimi perfshire edhe pajisjen me sinjalistike ndricuese te tij, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Kat 12 . STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, kerkohet domosdoshmerisht vleresimi dhe studimi sizmik i sheshit te ndertimit i cili do te perdoret gjate perllogaritjeve strukturore te objektit si dhe per vleresimin e kapaciteteve per te percaktuar skemen e nderhyrjes, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.

c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Argumentimi: Bazuar ne termat e references, parashikohet te realizohen parkimi, sheshe dhe sipërfaqe rekreative, si rrjedhoje vleresimi sizmik per kete kategori eshte i justifikuar pasi do te kemi te bejme me vepra te infrastruktures rrugore per te cilat pritet te kete dhe integrim me infrastructure ekzistuese etj.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon stafin me kualifikimet e duhura, drejtues teknik të shoqërisë, të përfshirë në Licencën e Shoqërisë për Projektim të aftë për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas objektit të kësaj kontrate vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licencë profesionale, CV dhe libeze pune dhe të figuroje në listepagesa për muajin e fundit të deklaruar, si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi Konstruktore
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/ Inxhinier Topograf
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e emrit të Inxhinierit nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrave dhe objektiva të përshkruara të Termat e Referencës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështiresie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilën kërkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndërtimit do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohet që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndërtimi konstruktor**, pjesë e stafit teknik.
- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit të peizazhit subjekt i kësaj procedure, si objekte të një kategorie të vecante për të cilën gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) Arkitekti** si staf teknik (arkitekte godinash, peisazhi, etj).
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) gjeodet** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve. Si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri hidroteknik** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të sistemeve elektrike parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri elektrik**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të studimeve gjeologjike dhe hidrollogjike që parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri gjeolog/Hidrollogjik**, si pjesë e stafit teknik.
- Meqenëse objekti i ri parashikohet të ketë sisteme mekanike, sisteme të ngrohjes nevojitet që për hartimin e projekteve të kemi prezencën e **Ing. Mekanik**.
- Punimet për shërbimet që ofrohen nga **inxhinieri gjeofizik/sizmiolog** bazuar pikave të licencës së kërkuar konkretisht për punime dhe vlerësime të inxhinierise gjeologo-sizmike, konkretisht në këto objekte meqenëse kemi ndërtesa të reja si dhe vlerësim të gjendjes së godinës ekzistuese lind nevoja e prezencës së një inxhinier sizmiolog/inxhinier gjeofizik për kategorinë e sipërcituar për vlerësimin sizmiologjik.
- Meqenëse objekti i ri parashikohet të ketë sisteme të vezhgimit të kamerave, sisteme audio vizive, rrjetin data të internetit etj nevojitet të kemi prezencën e **Ing Elektronik**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV dhe license

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë

Argumentim: Ne baze te pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 41, pika4/b te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Meqense kemi te bejme me ndertimin e nje objekti kompleks sic jane qendrat multifunksionale prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht :

- Sherbimet per projektimin arkitektonik priten te kene nje volumin te moderuar te projekteve qe realizohen per nivelin e objekteve dhe realizimit te peisazhit subjekt i kesaj procedure, si objekte te nje kategorie te vecante per te cilen gjykohet si e enevjshme prezenca e te pakten 1 (nje)Arkitekt si staf ndihmes (arkitekthe godinash, peisazhi etj)
- Punimet per sherbimin e projekteve strukture kane gjithashtu nje volum te rendesishem pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndertimit do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi pjese e stafit ndihmes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punësim mesatar i të paktën **15** (pesëmbëdhjete) personave, për muajin e fundit të deklaruar vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllëgaritur bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të References

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të kontraktuar eksperte si më poshtë:

- 1 (nje) punonjes te pajisur me certificate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis;
- 1 (nje) Auditues energjistik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;
- 1 (nje) Ekspert Zjarrefikes
- 1 (nje) ekspert restaurator i licensuar inxhinier/arkitekt te cilet zoterojne licensen perkatese ku te perfshihet pikat : P/A/6 Projektim ne konservim dhe restaurim i arkitektures se projektuar

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV, Certifikatat perkatese (te vlefshme) dhe license.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Argumentim: Ne baze te pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 41, pika 4/b te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomik te deshmojne qe kane stafin, personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates specialisti i fushes anetar i njesie e prokurimit per vendosjet e stafit i eshte referuar termave te pergjithshme te references per objektet pjese e kesaj procedure, pjese e secilave do te jene te licensuar per sherbimet qe priten te realizohen. Meqense kemi te bejme me ndertimin e nje objekti kompleks sic jane qendrat multifunksionale prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperdarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht :

- Eksperi zjarrfikese eshte i domosdoshem te jete prezent gjate hartimit te projekteve te mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vleresimeve perkatese te fushes bazuar ne termat e references.
- 1 Auditues Energjitik i certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne ndertesa per realizimin e certifikates se eficenses se energjise.
- 1 punonjes te pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vkeresimin e Ndikimit ne Mjedis gjykohet si i domosdoshem per realizimin e VNM (Vleresime e ndikimit ne mjedis) per projektet qe do te realizohen.
- Ekspert restaurator i licensuar eshte i domosdoshem te jete prezent gjate hartimit te projekteve pasi objekti qe do te ndertohet ndodhet ne zone te mbrojtur ose zone tampon sipas Vendim nr. 827, datë 28.12.2023 për Deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “Qendër historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj “, pasi ky objekt duhet te mari leje edhe nga Ministria e Kultures.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te vërtetojë se është i pajisur me Certifikatat që vërtetojnë plotësimin e kapaciteteve të cilësisë të organizimit dhe zbatimit të standartave CE në aktivitetin e supervizimit në lidhje me fushat e meposhtme:

- Certifikatë Për Sistemin e Menaxhimit te Cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente;
- Certifikate Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit ISO 14001 - 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente .
- Certifikatë Për Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe Sigurisë ne Pune certifikatën ISO 45001-2018; ose ekuivalente
- Certifikate per Sistemin e Menaxhimit te Energjise ISO 50001:2018 (e vlefshme) ose ekuivalente;

Operatori Ekonomik duhet te paraqesë certifikatat e mësipërme te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedurës se prokurimit.

Certifikatat duhet të jenë te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë dhe brenda afatit të vlefshmërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Ne rastet e bashkimit te operatoreve , secili operator ekonomik duhet te paraqesë certifikatën sipas fushës se veprimtarisë se marre përsipër ne marrëveshjen e bashkimit te operatoreve ekonomik.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, "Per prokurimin publik", sipas të cilit "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".*

Certifikatat e cilesise janë vendosur në përputhje me detyrat dhe objektivat e përshkruara te Termat e Referencës.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete pajisje si me poshte ne pronesi ose me qera:

- 1- Pajisje per matje gjeodezike GPS;
- 1- Pajisje per matje gjeodezike total Station

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mesiperme jane vendosur ne perputhje me natyren e Njëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave

- 1- Pajisje per matje gjeodezike GPS; i domosdoshem per matjet dhe piketimet gjeodezike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

2- Pajisje per matje gjeodezike total Station- matjet, kuotat ne menyre me te detajuar ne objekt, piketimet gjeodezike.

Per plotesimin e kesaj kerkese duhet te paraqitet nje dokument i cili verteton pronesine ose aktin e marrjes me qera te tyre si dhe skeda teknike e ketyre pajisjeve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës, duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**